

KONTRATE SHERBIMI

E lidhur sot, me date 15.07.2017 (dymije e shtatembedhjete), ne Tirane, midis ketyre paleve kontraktuese:

“Prestige Home” me nipt L12325013U e perfaqesuar nga Z. Durime Paja me adrese Autostrada Tirane Durres km 12 Citypark.

Dhe

“UNIK Group” Sh.p.k., me seli ne Sky Tower, Kati X, Rruga Ibrahim Rugova e perfaqesuar nga Znj. Adela Halili ne cilesine e administratorit te saj, me NIPT nr. L52208044L (me poshte *i Porosituri*).

Neni 1

Objekti

Objekti i kesaj kontrate eshte vendosja e tabelave me reklama sipas mediaplanit.

Neni 2

Vlera e Kontrates dhe Pagesat

- 2.1 Vlera totale e kesaj kontrate eshte 4008 euro (katermije e tete euro). Kjo vlere e perfshin tvsh.
- 2.2 Pagesa do te behet, menjehere pas dorezimit te fatures.
- 2.3 Pagesa do te kryhet ne llogarine bankare te Unik Group:

ACC NAME : UNIK GROUP SHPK

IBAN ALL: AL2820511021952500CLPRCLALLE

NR I ACC : 402952500

BANKA KOMBETARE TREGTARE

Neni 3 Afatet

- 2.1 Data e fillimit te kontrates eshte data 15/07/2017 dhe perfundon ne 15/08/2017.

Neni 4 Shtojcat

- 2.1 Cdo shtese apo heqje e citylighteve gjate periudhes qe mbulon kjo kontrate do te rregullohet me nje amendim / aneks kontrate bashkengjitur kesaj kontrate.

Neni 5 Detyrimet

- 4.1 *Porositesi* do te furnizojte *te Porositurin* me design e nevojshme, apo printimet, per te realizuar vendosjen e imazhit
- 4.2 I Porosituri mban pergjegjesi per çdo demtim te mundshem te punimeve, pas levrimit te tyre nga klienti. Ne nje rast te tille *i Porosituri* duhet te njoftoje, si dhe te kryej zevendesimin e tyre te plote. Çdo vonese e verifikuar ne kushte te tilla sjell zgjatjen e afatit te percaktuar ne nenin 2, paragrafi 2.1.

Neni 6 Reklamimi

- 5.1 Porositesi është i detyruar të njoftojë me shkrim te Porositurin për problemet eventuale që mund të lindin në lidhje me cilësinë e shërbimit të ofruar. Nëse brenda afatit prej 2 (dy) javësh nga data e njoftimit me shkrim i Porosituri, nuk kthen përgjigje për reklamimin e bere, Porositesit i lind e drejta të tërhiqet nga kontrata.
- 5.2 Në rast se i Porosituri pushon së kryeri shërbimin për një periudhë një mujore, Porositesit i lind e drejta të tërhiqet nga kontrata, pa pasur detyrime të mëtejshme.

Neni 7

- 6.1 Çdo ndryshim që palët bien dakort të bëjnë në kontratë do të bëhet gjithmonë me shkrim dhe duke u nënshkruar e vulosur rregullisht nga secila palë.
- 6.2 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit të kontratës do të zgjidhen nga palët me mirëkuptim në përputhje me nenet e kontratës.
- 6.3 Në rast se nuk arrihet një zgjidhje e tillë palët do t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Tiranë për zgjidhjen e konfliktit.
- 6.4 Kjo kontratë u përpilua në 2 (dy) kopje identike në gjuhën shqipe. Palët pasi u njohën me përmbajtjen e saj e nënshkruan me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë.

PALET

**“PRESTIGE HOME”
DURIME PAJA**

**“Unik Group” Sh.p.k.
Adela Halili**



